

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** - DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtarin Murat Paçarada, duke vendosur në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [”H.K.”] me seli në Gjakovë, të cilën e përfaqëson avokat [”G.N.”] kundër të paditurave 1.[”A.K.”] nga Gjakova, dhe Ndërmarrja e re [”D...”] sh.p.k, me seli në Gjakovë, të cilën e përfaqëson objekti i kontestit, vërtetim i pronësisë në aksionet e shoqërisë tregtare, jashtë seancës gjyqësore, duke vepruar sipas parashtrësës së palës paditëse , gjykata me datën 03.01.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**NË BAZË TË HEQJES DORË NGA PADIA DHE KËRKESËPADIA**

**I. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesëpapia e paditësit [”A.K.”] nga Gjakova, që të vërtetohet se paditësi [”H.K.”] nga Gjakova në bazë të kontratës interne për shitblerjen e aksioneve të [”D...”] sh p.k, me dt.30.10.2015,të lidhur me të paditurin e parë [”A.K.”] nga Gjakova, e ka fituar pronësinë edhe në 50% të aksioneve, te kapitalit themeltar të paditurës së dytë [”D...”]sh.p.k.me seli në Gjakovë, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

**A r s y e t i m i**

Paditësi [H.K.”] me seli në Gjakovë, me datën 25.02.2019, ka paraqitur padi kundër të paditurit [”A.K.”] si dhe [”D...”] nga Gjakova për vërtetimin e pronësisë së aksioneve të shoqërisë tregtare.

Me parashtrësë e datës 30.12.2019,paditsi e ka tërhequr padinë dhe kërkesëpadinë ndaj palës së paditur, me arsyetim se të njëjtat e kanë zgjedhur kontestin me marrëveshje jashtëgjyqësore.


Meqenëse paditësi e ka tërhequr kërkesë-padinë në kuptim të nenit 149.2 të LPK-së, nuk është i nevojshëm pëlqimi i të paditurit, për çka gjykata në kuptim të nenit 149.1 të LPK-së, pa shqyrtim të matejm ka vendosur si në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 160.6 të LPK-së, në pjesën arsyetuese të këtij Aktgjykimi, janë dhen vetëm arsyet qe e justifikojnë dhënien e tij.

Në bazë të dhënave si ma lartë, si dhe në bazë të neneve 142,143,160 si dhe 149 të Ligjit për procedurën kontestimotre, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për çështje ekonomike  
IV-EK.C.nr.102/19,datë 03.01.2020

Gjyqtari,  
Murat Paçarada



UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.